



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranverorë

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 01
Prishtinë, më 25 janar 2012, në orën 10:00 sala N-225
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCIVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Ramiz Lladrovci, Valbona Dibra, Armend Zemaj, Adem Grabovci, Bali Muharremaj, Afrim Hoti dhe Albert Kinolli.

Mungoi: Murselj Haljilji.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri - koordinatore, KIPRED (staf mbështetës) – Artan Venhari dhe Albert Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 09.12.2011 dhe 14.12.2011,
3. Shqyrtimi i Raportit të punës së Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, për vitin 2011,
4. Të Ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri miratoi rendin e ditës pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 09.12.2011 dhe 14.12.2011

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri miratoi Procesverbalin e mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 09.12.2011 dhe 14.12.2011, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit të punës së Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, për vitin 2011

Kryetari – Komisioni edhe pse ka filluar punën me vonesë, megjithatë ka kryer objektivat me një rezultat të kënaqshëm. Ka mbajtur 33 mbledhje të rregullta, në të cilat përpos zyrës së auditorit, kanë prezantuar edhe ministra e zëvendëskryeministra dhe përfaqësues të tjerë të OB. Në të gjitha rastet Komisioni ka pas për bazë edhe rekomandimet nga viti paraprak. Në përgjithësi në këtë drejtim Komisioni nuk ka qenë i kënaqur. Në përgjithësi OB nuk kanë shpalosur rekomandimet edhe pse ka disa përjashtime. Disa raporte kthyese flasin për masa serioze të ndërmarra nga OB, ndërsa te disa të tjera Komisioni ka konstatuar se pjesërisht janë adresuar rekomandimet, por ka pasur edhe raste kur Komisioni nuk ka qenë i kënaqur me raportet kthyese të OB-ve. Në rastet e fundit Komisioni i ka rekomanduar ZAP-it që këto OB të jenë prioritet i auditimit në këtë vit.

Problematikat kryesore, apo të gjeturat më të mëdha kanë pasur të bëjnë me: *shpenzimin e buxhetit në tre mujorin e fundit, procesi i prokurimit ka pasur lëshime pothuajse në të gjitha OB, ka pas keqmenaxhim dhe ka pasur simptoma për keqpërdorim, regjistrimi i pasurisë-proces ky që nuk është përshkruar në harmoni me dispozitat ligjore- mendimi i Komisionit ka qenë që nuk ka raportim kualitativ nëse nuk ka të dhëna mbi pasuritë, mos-harmonizimi dhe mos - prezantimi në formën standarde të kërkuar lenë mundësi të keqpërdorimit të asaj pasurie, mos - ruajtja e dokumentacioneve të tenderëve, mosfunksionimi i auditimit të brendshëm nga OB. Janë themeluar komitetet e auditimit, por janë larg nga ajo që kërkohet. Aty ku ka funksionuar auditimi i brendshëm gabimet kanë qenë më të vogla. Komisioni ka konstatuar se ka pasur raste kur rekomandimet e auditorëve të brendshëm nuk janë përfillur fare. ZAP duhet të shtoj numrin auditimeve të performancës.*

Falënderoj stafin mbështetës të cilët kanë qenë në nivelin e lartë profesional si dhe KIPRED-in për mbështetjen profesionale të vazhdueshme në punën e këtij Komisionit.

Armend Zemaj – Komisioni me punën e tij ka arritur në nivelin për çka edhe është krijuar, përkundër vështirësive. Shpeshherë baza ligjore ka qenë pengesë që Komisioni të kryej veprimtarinë ashtu siç kërkohet. Komisioni ka arritur ta mbroj qëllimin e tij, e ai është mbrojtja e shpenzimit të parasë publike. Insistoi në atë që Komisioni të mos jetë edukativ për OB-të, por të ketë rekomandime konkrete, që mbeten për tu adresuar pastaj nga ekzekutivi dhe OB-të. Duhet të përshpejtohet agjenda e mbajtjes së takimeve të Komisionit, sepse pavarësisht që Komisioni ka mbajtur mbledhje çdo javë, prapë nuk ka arritur që të shqyrtoj të gjitha raportet e ZAP-it.

Propozoi që pjesë e raportit të jetë edhe vlerësimi përkatësisht diskutimi i anëtarëve për punën e Komisionit gjatë vitit 2011.

Ramiz Lladrovci – Parlamenti ka filluar me vonesë dhe kjo ndoshta e ka bërë që Komisioni të mos të jetë në nivelin e duhur. Megjithatë Komisioni edhe pse ka filluar me vonesë, ka arritur të punoj shumë. Nga vizitat e realizuara Komisioni ka përfutur përvoja të mira dhe besoj që në këtë vit do të punoj edhe më mirë. Bashkëpunimi ka qenë i mirë në Komision, sepse të gjithëve ju ka interesuar se si po menaxhohet paraja publike, kjo pra duke lënë anash problemet politike.

Adem Grabovci- Konstituimi me vonesë i institucioneve ka reflektuar edhe në punën e Komisioneve. Megjithatë Komisioni ka një fushëveprimtari shumë të gjerë, por ka edhe mundësi për të ndikuar pozitivisht në punën e institucioneve për shpenzimin e parasë publike. Komisioni është ndeshur me probleme të akumuluar vit pas viti, megjithatë duhet insistuar që

këto të gjetura të korigjohen. Për këtë Komisioni duhet të insistoj që rekomandimet të adresohen plotësisht, sepse vetëm identifikimi i gabimeve nuk nënkupton asgjë. Komisioni është ai i cili duhet të jap kontributin që për të gjetura, të ndërmarr hapa konkretë, por duhet të bëjë punën e tij edhe për të hequr perceptimin negativ që është krijuar për punën e institucioneve.

Albert Kinolli – Përgëzoi anëtarët e Komisionit për punën e bërë si dhe falënderoj stafin mbështetës për punën profesionale në mbështetje të Komisionit. Komisioni ka arritur të harmonizohet si i tillë. Komisioni është dakorduar që në mbledhje të ftohen të parët e institucioneve, ndoshta duhet rishqyrtuar ky vendim dhe duhet vendosur se si do të veprohet në këtë vit.

Afrim Hoti – Tha se duhet të merret shembull Komisioni në Skotlandë i cili ishte mbipartiak dhe anëtarët e Komisionit vepronin si apolitik. Kjo duhet të ndodhë edhe me Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike në Kosovë.

Valbona Dibra- Falënderoj stafin mbështetës për një raport kaq përmbledhës dhe të mirë i cili pasqyron punën e mirë - të përbashkët - të Komisionit gjatë vitit 2011. Propozoi që në tabelë të përshihet edhe numri i ministrave që kanë raportuar në Komision, meqenëse kjo prezanton edhe nivelin mbikëqyrës që ka bërë Komisioni. Domethënë sa ministra e zëvendëskryeministra janë sjellë për të raportuar në Komision. Në brendi të raportit shpjegohet se para Komisionit kanë raportuar ministra e zëvendëskryeministra, por ndoshta do të ishte mirë që kjo të figuroj edhe në tabelë.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri nxori këtë

PËRFUNDIM

- 1. Miratohet Raporti i punës së Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, për vitin 2011.**
- 2. Pjesë e raportit është edhe diskutimi –vlerësimi i anëtarëve të Komisionit për punën e Komisionit gjatë vitit 2011.**

3. Të Ndryshme

a). Diskutim rreth angazhimit të ekspertëve në punën e Komisionit

Kryetari - Njoftoi anëtarët e Komisionit se NDI ka ofruar mbështetje për bashkëfinancim të ekspertëve. Për rastet e bashkëfinancimit duhet të vendos Komisioni me votim. Para jush keni listën aktuale të ekspertëve të cilën e posedon dhe e ka votuar Komisioni, bashkë me UA për administrimin e buxhetit të Komisioneve.

Armend Zemaj- Komisioni ka listën e vet të ekspertëve dhe varësisht nga çështjet mund ta angazhoj ata në bashkëpunim me NDI-në. Në këtë listë janë përfshirë njerëz që kanë njohuri dhe bien në fushën e këtij Komisioni.

Adem Grabovci – Komisioni ka nevojë për angazhimin e ekspertëve të jashtëm, por duhet pasur kujdes që të angazhohet më i miri, në mënyrë që të arrihet efekti i angazhimit të ekspertëve. Pra, anëtarët e Komisionit duhet të shkarkohen nga çdo ngarkesë në mënyrë që ekspertit në aspektin profesional të ofroj përvojën e tij. Propozoi që lista aktuale të ekspertëve të shqyrtohet nga anëtarët e Komisionit dhe pastaj Komisioni në një nga mbledhjet e radhës të vendosi lidhur me këtë çështje.

Valbona Dibra – Kërko mendimin e anëtarëve të Komisionit se si do të bëhet angazhimi i

ekspertëve nga lista aktuale. A do të jetë ky një angazhim permanent apo kjo do të bëhet varësisht nga lëndët specifike.

Kryetari konstatoi se, Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri nxori këtë

Përfundim

Lista e ekspertëve dhe mundësia e angazhimit të tyre në punën e Komisionit, do të diskutohet në një nga mbledhjet e radhës të Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 11:45

E Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ali Sadriu